



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dituruar Dokument / Prillog Kryesori / Detyrimi	30.12.2022	2 viti god year	
Organ / Njësia Organi / Njësia Org. / Unit.	Rr. Post Rr. Post Post No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	8693/2022		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 607/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani kryetar, Jeton Koca, dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 607/2021, të datës 02.07.2021 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi [redacted] nga Komuna e Prishtinës, , Sipas Aktgjykimit A. NR. 2114/2021, të datës 22.11.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZHET si e pa bazuar ankesa A.nr.607/2021, e datës 02.07.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi vërejtja e datës 14.06.2021, me numër protokoll 191/20221, i shqiptuar nga Mbikëqyrësi Drejtpërdrejtë.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] sipas shkreesave të lëndës i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës me datë 02.07.2021, me numër protokoll 3417/2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vërejtjes me shkrim që ia ka shqiptuar Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë me datë 14.06.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 06.07.2021, me numër protokoll 3490/2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa me datë 27.07.2021 me numër protokoll 3918/2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës me shkresat e bashkëngjitura.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.08.2021 përmes shkresës me numër protokoll 4244/2021, ka njoftuar ankuesin [redacted] se nuk mund të shqyrtoj dhe vendos lidhur me ankesën A.nr.607/2021, të datës 02.07.2021, për shkak së Këshilli nuk ka anëtarë duke e udhëzuar të njëjtin që të inicioj procedurë gjyqësore pran Gjykatës Kompetente.

Ankuesi, pas njoftimit të datës 16.08.2021 të Këshillit, ka hapur konflikt administrativ në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me aktgjykimin Anr.2114/2021 të datës 22.11.2022 ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit dhe ka anuluar njoftimin e datës 26.08.2021 të KPMSHCK-së, duke e obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr.607/2021 të datës 02.07.2021.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën A.nr. 607/2021 e datës 02.07.2021, me numër protokoll 3417/2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtja me shkrim e datës 14.06.2021; e- maili i datës 07.06.2021; Raporti i Detajuar; Akt Emërimi i datës 13.01.2012; e-maili i datës 15.06.2021; e-maili i datës 27.04.2021; e- maili i datës 02.12.2020; e - maili i datës 31.07.2020; e- maili i datës 02.06.2020; e -maili i datës 11.03.2020; e -maili i datës 22.01.2020;Përgjigje në ankesë e datës 27.07.2021, me numër protokoll 3918/2021; Njoftimi i datës 16.08.2021, me numër protokoll 4244/2021;Aktgjykimi A. Nr. 2114/2021, i datës 22.11.2022, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesi [redacted] **është e pa bazuar, SEPSE:**

Kolegji ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit, pasi që i njëjti pretendon se me vonesën lidhur me përfundimin e kontrollës nuk është shkaktuar asnjë dëm palëve, gjithashtu ankuesi pretendon se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk ka vepruar sipas nenit 50 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, por Kolegji pas administrimit të shkresave të lëndës ka gjetur se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka komunikuar me ankuesin në muajin qershor të vitit 2021 lidhur me mbylljet e kontrollave të filluara gjatë vitit 2019 dhe është udhëzuar që këto kontrollera të mbylljen deri më datë 04.06.2021, por ankuesi kontrollën tek biznesi me regjistrimi nr.ID810683146, nuk ka arritur ta kryj me kohë, prandaj ndërlidhur me këtë ankuesi ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht nenin 25 ku përcaktohet se: *"Detyrimi i respektimit të ligjit, mbrojtjes të interesit të shtetit dhe të drejtave të njeriut 1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike"*, si dhe nenin 26 paragrafi 1. *"Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësi i tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit"*. Prandaj, ndërlidhur me këtë fakt Udhëheqësi i drejtpërdrejtë ka bërë përcaktim të drejtë të shkeljes nga ana e ankuesit duke vepruar në përputhje të plotë me nenin 45 të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *"Përgjegjësia disiplinore 1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit"*. Andaj në vlerësimin e Kolegjit mos kryerja me kohë e



kontrollës ka shkaktuar dëm te institucioni në këtë rast tek ATK, pasi që e njëjta nuk ka realizuar me kohë planin e kontroleve për vitin 2021.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**LËNDA A.NR. 607/2021**

**Rushit KAJTAZI**

Procesmbajtës

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

Ankuesit

Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;

Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;

Arkivit të KPMSHCK-së,